



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Kërkesa nr. 25/

Data *10.5.2023*
Nr. Prot *4910*

KËRKUES: KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

OBJEKTI: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

DREJTUAR: KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, ka depozituar denoncimet regjistruar me numër 182 ID, 183 ID, 180 ID, 172 ID, 173 ID, 219 ID si dhe sinjalizuesi ka depozituar denoncimet 226 ID, 227 ID.

Janë administruar indicie për organizimin e 8 (tetë) veprimtarive publike, nga 5 (pesë) institucione publike, për të cilat pretendohet se janë kryer në kundërshtim me përcaktimet e neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerëson se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92, 171, pika1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe

bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve/denoncimeve.

Në vijim të procedurës administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vijoi hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqe.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike email, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljevetë pretenduara.

Institucionet e denoncuara janë si më poshtë vijon:

- 1. Denoncimet e regjistruara me nr. 172 ID dhe 173 ID, ndaj bashkisë Cërrik**
- 2. Denoncim regjistruar me nr. 219 ID ndaj Bashkisë Elbasan**
- 3. Denoncimet regjistruar me nr. 182 ID dhe 183 ID ndaj Bashkisë Kamëz**
- 4. Denoncim regjistruar me nr. 180 ID, ndaj Bashkisë Poliçan**
- 5. Denoncimet e regjistruara me nr. 226 ID dhe 227 ID, ndaj Bashkisë Tropojë**

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 219 ID . Kryetari i bashkisë Elbasan, nëpërmjet vënies në dispozicion të aktiviteteve për kryerjen e thirrjeve elektorale, përbën shkelje të detyrimeve të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 172 ID dhe 173 ID ID, kryetari i bashkisë Cërrik, nëpërmjet vënies në dispozicion të aktiviteteve për kryerjen e thirrjeve elektorale, ka shkelur parashikimet të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 182 ID dhe 183 ID ID, kryetari i bashkisë Kamëz, nëpërmjet vënies në dispozicion të aktiviteteve për kryerjen e thirrjeve elektorale, ka shkelur parashikimet të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.

Për rrjedhojë, referuar nenit nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, *dënohet me gjobë nga 3 000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.*

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator”, i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

- a) Z. Gledjan Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan, në vlerën 10,000 (dhjetë mijë) lekë;
- b) Z. Andis Salla, kryetar i bashkisë Cërrik, në vlerën 10,000 (dhjetë mijë) lekë;
- c) Z. Rakip Suli, kryetar i bashkisë Kamëz, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

Nga të dhënat, rezulton se z. Gledjan Llatja, është përsëritës për shkeljen.

Nga të dhënat, rezulton se z. Andis Salla, është përsëritës për shkeljen.

Nga të dhënat, rezulton se z. Rakip Suli, është përsëritës për shkeljen.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendim nr. 470, datë 09.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
- Denoncimi administruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr.219 ID për bashkinë Elbasan;
- Denoncimi administruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr.172 dhe 173 ID për bashkinë Cërrik.
- Denoncimi administruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr.182 dhe 183 ID për bashkinë Kamëz
- Provat link në rrjetin social Facebook për bashkinë Cërrik:
<https://www.facebook.com/Gjikhuri.Damian/videos/6308649892479310/>
<https://www.facebook.com/Gjikhuri.Damian/videos/168829365909119>
- Provat link në rrjetin social Facebook për bashkinë Kamëz:
<https://www.facebook.com/profile.php?id=100077339029573>
<https://www.facebook.com/profile.php?id=100077339029573>

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:
E. Mema
I. Horanlliu
M. Koja
A. Lamçe
Y. Merkaç

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Subject: Kerkese per informacion, bashkia Cërrik (173)

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është depozituar denoncim nëpërmjet postës elektronike të datës 11.03.2023, nga KRIIK ALBANIA ku pretendohet se:

"Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqe në datën 25.02.2023 zhvillimin e veprimtarisë publike "Inspektim në kantierin e zbatimit të infrastrukturës publike Shales" në datën 04.03.2023. Vendi i Zhvillimit: Shalës, NJA Shales. Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan, deputet i Qarkut Vlorë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste z. Damian Gjijnuri. Zhvillimi i këtij aktiviteti është publikuar në faqen Facebook të kryetarit të Bashkisë Cërrik në datën 05.03.2023: Lagja e "Çapallarëve" në fshatin Shalës është një tjetër kantier pune, të cilin e vizituam me Damianin. Në këtë lagje kemi nisur punën për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës së kësaj lagje duke i dhënë në këtë mënyrë zgjidhje një prej shqetësimeve më madhore të këtyre banorëve. #BashkiaCërrik#SkaKohëPërPushim #ShqipëriaeArdhmjaJonëAL"

si dhe në faqen Facebook të drejtuesit politik Qarkut Elbasan z. Damian Gjijnuri në datën 04.03.2023:

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim

Ky aktivitet "Inspektim" i organizuar nga Bashkia Cërrik është përdorur haptas dhe qartas për të kryer diskutime elektorale dhe hedhur premtime të drejtpërdrejta në emër të maxhorancës në funksion të zgjedhjeve të 14 majit. Drejtuesi politik i PS për Qarkun Elbasan z. Damian Gjijnuri: "(...) Mirë mirë po ja edhe ky do mbështetje. Ky bën punë, ju e mbështesni më shumë, do bëjë edhe më shumë punë. Kështu funksionon. (...)
Ama, ne duhet ta falënderojmë këtë si kryetar bashkie për punët që ka bërë, dhe ju jap llafin që ky ka punuar shumë mirë, me mbështetjen tuaj do marrë dhe mbështetjen tonë më të madhe, edhe të kryeministrit Rama me projekte të tjera."

Fjalimi i plotë në këtë

link <https://www.facebook.com/Gjijnuri.Damian/videos/6308649892479310/>:"

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për datën, orën, organizatorin, tematikën e aktiviteteve, pjesëmarrjen dhe mediatizimin, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e këtij email-i.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

From: denoncime
Sent: Monday, March 13, 2023 3:41 PM
To: Florenc Doka <dokaflorenc@yahoo.com>
Cc: info@kriik.al <info@kriik.al>
Subject: Kërkesë për informacion, Bashkia Cërrik (172)

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është depozituar denoncim nëpërmjet postës elektronike të datës 11.03.2023, nga KRIIK ALBANIA ku pretendohet se:

"Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqe në datën 25.02.2023 zhvillimin e veprimtarisë publike "Inspektim ne kantierin e zbatimit te infrastrukturës publike Selvijas" në datën 06.03.2023. Vendi i Zhvillimit: Selvijas, NJA Klos. Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan, deputet i Qarkut Vlorë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste z. Damian Gjikhuri. Zhvillimi i këtij aktiviteti është publikuar në faqen Facebook të kryetarit të Bashkisë Cërrik në datën 07.03.2023:

SELVIAS Bashkë me banorët e fshatit Selvias dhe drejtuesin politik të qarkut Elbasan Damianin, pamë nga afër punimet që kemi nisur për rregullimin dhe asfaltimin e rrugës ë këtij fshati. Ka vetëm pak kohë që ka nisur puna dhe ky investim i financuar tërësisht me fondet e bashkisë, përfshin shtrimin me asfalt, ndërtimin e mureve rrethues dhe pajisjen me ndriçim e trotuare sipas standardeve. #BashkiaCërrik#ShqipëriaeArdhmjaJonë#SkaKohëPërPushim" si dhe në faqen Facebook të drejtuesit politik Qarkut Elbasan z. Damian Gjikhuri në datën 04.03.2023:

"Cërrik Në Njësinë Administrative Klos ku vijon puna për rehabilitimin e plotë të rrugës në fshatin Selvias. #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim" Ky aktivitet "Inspektim" i organizuar nga Bashkia Cërrik është përdorur haptas dhe qartas për të kryer diskutime elektorale dhe hedhur premtime të drejtpërdrejta në emër të maxhorancës në funksion të zgjedhjeve të 14 majit. Drejtuesi politik i PS për Qarkun Elbasan z. Damian Gjikhuri:

"(...) Ky e ka justifikuar me punë, dhe jo më kot Edi Rama thotë është nga kryebashkiakët më të mirë, dhe ne do ta mbështesim. Se ne do mbështesim njerëzit e punës. Ky e ka mirëadministruar fondet e bashkisë. Po ndërhy, dhe qytetin, madje për mua i ka mbyllur gjithë lagjet në qytet, sot ishim të gjithë, edhe me fshatin po ndërhyet avash avash dhe gjërat do shkojnë aty ku duhet. E rëndësishme është që ky të vazhdojë këtë ritëm, por edhe ky do mbështetjen tuaj. (...)

Ne kemi njerëzit më të mirë dhe po bëjmë më shumë për Shqipërinë se sa të tjerët. Tashi të tjerët kanë hallet e revolucionit, ne kemi hallin si të rregullojmë rrugët e fshatrave, si të rregullojmë energjinë, kjo është detyra jonë. Edhe kështu do të vazhdojmë. Ata le të merren me revolucionin e Saliut me Ilirin. Kështu që dy zgjedhje kanë njerëzit, revolucionin e tyre dhe punën e njerëzve të thjeshtë. T'i gëzoni dhe paçi vetëm të mira."

Fjalimi i plotë në këtë link

<https://www.facebook.com/Gjknuri.Damian/videos/168829365909119>".

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për datën, orën, organizatorin, tematikën e aktivitetëve, pjesëmarrjen dhe mediatizimin, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e këtij email-i.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Live Shows Explore

Search videos



Damian Gjikhuri was live.
March 4 at 4:58 PM · · **Cërrik** Në fshatin Shalës, ku janë drejt fundit punimet dhe brenda 1 muaji banorët do kenë gati rrug...

Most relevant

Nadiola Rapi · ·
Bravo!

Bledar Karkanaj · ·
Respekt!


[View more comments](#)
2 of 409

Cërrik

Like Comment Share

4.6K · 451 comments · 15K views

Related Videos



Facebook X KOZ Shqipëri Facebook X Krci KOZ X Inspektim ne Kantierin e Zbatimit - X +

https://aktivitetetepublikat.gov.al/2023/02/25/inspektim-ne-kantierin-e-zbatimit-te-infrastruktures-publike-23/

FAQJA KRYESORE | AKTIVITETE RAPORTUARA | AKTIVITETE TE NDALUARA | HYR

Inspektim ne kantierin e zbatimit te infrastruktures publike

Bashkia e Carrick Ujeçajllës Kanalizime Carrick | 25/02/2023 | Aktivitete te raportuara

Inspektim ne kantierin e zbatimit te infrastruktures publike Selvisjas

- Ligji i Adhimit te Inspektimit Kontroll
- Data: 04/03/2023
- Ora: 11:00
- Vendi i Zhvillimit: Selvisjas, NJA Klis
- Shiriti: Shqipëri
- Qarku: Elbasan
- Bashkia: Carrick
- Niveli Administrativ: Klos
- Folia Kryesore: Damian Gjilkuari / Analfis Salla
- Pozicioni: Drejtuesi Politik, Qarku / Kryetari i Bashkise
- Pjesëmarrësit: Damian Gjilkuari / Andis Salla / Administratori i Reshjes / Komunitet
- Mjetet e përdorura: Telefon dhe kompjuter
- Llogaritja për publikun: Po
- Personi përgjegjës për raportim: Florenc Doka
- Personi ngarkuar nga ligji për raportim (Sekretari i Përgjithshëm): Florenc Doka

Aktori i Lehtësuar

Rijetot Sociale

Legjislacioni

- Kushtetuta
- Kodi Zgjedhor
- Ligji për partitë politike
- Ligji dekriminalizimit

Transparenca

- Koordinatori
- Programi
- Modellet
- Informacione

© 2023 | Kombinat Qendror i Zgjedhjeve - Të gjithë të drejtat e rezervuara | Përdorimi dhe Privaciteti

10:07 AM 20°C Mostly cloudy 03/03/2023

182-183

Kërkesë për informacion, bashkia Kamëz (182, 183)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Tue 3/21/2023 12:33 PM

To: prelgjonpalaj@gmail.com <prelgjonpalaj@gmail.com>

Cc: info@kriik.al <info@kriik.al>

Bcc: Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 20.03.2023, në adresën e e-mail-it, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar raporti IX i KRIIK Albania, për gjetjet dhe rekomandimet për javën 10 - 16 mars 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve. Nëpërmjet këtij raporti, është marrë indicie për publikimin e 2 (dy) veprimtarive me karakter politik, në faqen zyrtare të institucionit Tuaj.

1. Në **Faqen Zyrtare të Bashkisë Kamëz** është postuar me video një takim me strukturat e Partisë Socialiste në Kamëz. Postimi gjendet në këtë link <https://www.facebook.com/profile.php?id=100077339029573> dhe mban datën 4 mars 2023. Përmbajtja e postimit: "*Me Linditën dhe Rakipin, për t'u takuar me strukturat plot energji në Kamëz- jam krenar për punën e jashtëzakonshme të Partisë Socialiste*"
2. Në **Faqen Zyrtare të Bashkisë Kamëz** është postuar me video një takim me strukturat e Partisë Socialiste në Kamëz. Postimi gjendet në këtë link <https://www.facebook.com/profile.php?id=100077339029573> dhe mban datën 17 shkurt 2023. Përmbajtja e postimit "*Bashkë me të Deleguarën Politike Znj. Lindita Nikolla, gjatë takimit me Shtabin e Partisë Socialiste Kamëz, ku diskutuam mbi organizimin e partisë dhe strukturës, për zgjedhjet e 14 majit. Sot jemi më të fortë, me një bilanc pune konkret dhe me një strukturë më të motivuar se kurrë, të gatshëm për të arritur një rezultat spektakolar, pas 87 ditësh në Bashkinë Kamëz*"

Denoncuesi pretendon se publikimet e bëra në faqen zyrtare të institucionit tuaj, bien në kundërshtim me nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e këtij email-i.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 20.03.2023, në adresën e e-mail-it, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar raporti IX i KRIIK Albania, për gjetjet dhe rekomandimet për javën 10 - 16 mars 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve. Nëpërmjet këtij raporti, është marrë indicie për publikimin e 2 (dy) veprimtarive me karakter politik, në faqen zyrtare të institucionit Tuaj.

1. Në **Faqen Zyrtare të Bashkisë Kamëz** është postuar me video një takim me strukturat e Partisë Socialiste në Kamëz. Postimi gjendet në këtë link <https://www.facebook.com/profile.php?id=100077339029573> dhe mban datën 4 mars 2023. Përmbajtja e postimit: *"Me Linditën dhe Rakipin, për t'u takuar me strukturat plot energji në Kamëz- jam krenar për punën e jashtëzakonshme të Partisë Socialiste"*
2. Në **Faqen Zyrtare të Bashkisë Kamëz** është postuar me video një takim me strukturat e Partisë Socialiste në Kamëz. Postimi gjendet në këtë link <https://www.facebook.com/profile.php?id=100077339029573> dhe mban datën 17 shkurt 2023. Përmbajtja e postimit *"Bashkë me të Deleguarën Politike Znj. Lindita Nikolla, gjatë takimit me Shtabin e Partisë Socialiste Kamëz, ku diskutuam mbi organizimin e partisë dhe strukturës, për zgjedhjet e 14 majit. Sot jemi më të fortë, me një bilanc pune konkret dhe me një strukturë më të motivuar se kurrë, të gatshëm për të arritur një rezultat spektakolar, pas 87 ditësh në Bashkinë Kamëz"*

Denoncuesi pretendon se publikimet e bëra në faqen zyrtare të institucionit tuaj, bien në kundërshtim me nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijani e këtij email-i.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Fotografia Pelicula

Prezantimi

Mirëse vini në faqen zyrtare të Bashkisë Kamez.

- Faqe - Interesat
- bashkikamez@gmail.com
- www.kamez.gov.al
- Hapur tani

Fotografitë



Shiko të gjitha fotografitë

Privatësi - Kushtetë e përdorimit - Reklamimi - Të gjithat e reklamave - Kujtim - Mbrojtja e Nënës së 2023

Shikoni një koment...

Bashkia Kamez



Rakip Suli

Bashkia me te Deleguarin Politike Znj. Lindita Nikolla, gjate takimit me Shitabin e Partise Socialiste Kamez, ku diskutuam mbi organizimin e garise dhe strukturen per zgjedhjet e 14 majit.

Sot jemi me te forte, me nje bilanc pune konkret dhe me nje strukture me te motivuar se kurre, te gashem per te arritur nje rezultat spektakolar, bas 87 ditesh ne Bashkine Kamez.

1 koment

Pëlqej

Komente

Ndaj

Bashkia Kamez

Prezantimi

Mirësevini në faqen zyrtare të Bashkisë Kamez.

- 📄 **Faqe** - Interesat
- ✉️ bashkia@kamez.com
- 🌐 www.kamez.gov.al
- 📍 Hapsirë tarrë

Fotografitë

Shiko të gjitha fotografitë



Procesi i kësaj faqeje përfundoi me sukses. | Bashkia Kamez | Zgjedhjet e rekrutimit të Kështjës - Mbrojtja e Mbrojtjes | Mbrojtja e Mbrojtjes | Mbrojtja e Mbrojtjes

13 | Pëlqej | Komento | Ndaj | Shruaj një koment...



Enon Velaj ishte drejtërdritë.
 Me Lindjen dhe Raxhin, për t'u takuar me strukturat e energjisë në Kamez. Jam kërenar për punën e jashtëzakonshme të Partisë Socialiste. Këtu, një qytet ku vijnë me kokën lart për të gjitha investimet në shkollë, kopshta, qerdhe e murgë. Bashkia.

76 | Pëlqej | Komento | Ndaj | Shruaj një koment...



Bashkia Kamez | 4 Mars | 17°C Partly sunny

Kerkese per informacion, Bashkia Elbasan (219)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Tue 3/28/2023 9:19 AM

To: arjola.memetaj@elbasani.gov.al <arjola.memetaj@elbasani.gov.al>

Cc: info@kriik.al <info@kriik.al>

Bcc: Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Përshëndetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 25.03.2023, në adresën e e-mail-it, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar raporti X i Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRILK), për gjetjet dhe rekomandimet për javën 17 - 23 Mars 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve. Nëpërmjet këtij raporti, është administruar denoncimi për Institucionin Tuaj, nëpërmjet të cilit pretendohet si më poshtë vijon:

"Në datën 22 mars 2023, Bashkia Elbasan ka postuar në faqen e vet në Facebook (më poshtë përmbajtja dhe foto/printscreens e faqes):

" Njësia 5 - ku ka a nisur puna për rikonstrukcionin e rrugës "Theofan Popa"
#SkaKohëPërPushim "

Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan z. Damian Gjijnuri:

"Elbasan 🇹🇰

Elbasan Vijnë punimet për rehabilitimin e plotë të rrugës "Theofan Popa" në lagjen Haxhias.

#TëBashkuarJoTëNdarë

#ShqipëriaEArdhmjaJonë

#SkaKohëPërPushim "

Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga Bashkia Elbasan.

Në njoftimin e bërë deklarohet paraprakisht nga Bashkia se pjesëmarrësit do të ishin:

"Damian Gjijnuri, udhëheqës politik i Qarkut Elbasan, deputete, Prefekti i Qarkut Elbasan, Kryetari i Keshillit të Qarkut, Administratori i Njesise nr.5 dhe Administratori NJA nr.6".

Përpos përdorimit të sloganeve elektorale të Partisë Socialiste për Zgjedhjet Parlamentare 2021, në videon e postuar (linku më sipër), pas minutës 3.15 kemi një sërë artikulimesh elektorale që shkojnë në mbështetje të Kandidatit z. Llatja dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste.

Theksohet se në Faqen Zyrtare në Facebook të Kryetari të Bashkisë Elbasan si dhe Drejtuesit Politik të Qarkut Elbasan z. Gjijnuri gjenden disa postime të aktiviteteve të Bashkisë Elbasan, në të cilat ka marrë pjesë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan, ku pothuajse në të gjitha ky i fundit evidentohet lehtësisht që bën fushatë të hapur elektorale.



Përsa më sipër, kërkohet nga ana juaj të na informoni për datën, orën, organizatorin, tematikën e aktivitetëve, pjesëmarrjen dhe mediatizimin, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e këtij email-i.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

